



09:48 / 03.12.2020



HAJNAT VJEDHIN ARMË, STOLI DHE PARA

Raste të shumta të veprës penale “Vjedhje e rëndë” po raportohen çdo ditë në Policinë e Kosovës.

Vetëm gjatë 24 orëve të fundit në territorin e Kosovës kanë ndodhur shtatë vjedhje të rënda dhe një vjedhje e rëndë në tentativë, shkruan IndeksOnline.

Në bazë të të dhënave të ofruara nga raporti 24 orësh i Policisë, hajnat kanë vjedhur gjësende të ndryshme.

Ata për 24 orë vjedhën armë, dokumente, para, kartela, çantë të krahut, stoli, paisje elektronike e një kasafortë.

Raporti 24 orësh:

Prishtinë 02.12.2020-04:20. Ankuesi mashkull kosovar ka raportuar se deri sa ka qenë në shtëpi kishte vërejtur nga dritarja se dy persona të panjohur kishin qenë duke qëndruar tek rrethoja e shtëpisë së tij ku njëri prej tyre dysohet të ketë pasur në dorë një armë të gjatë. Me të vërejtur ankuesin të njëjtit ishin larguar në drejtim të panjohur. Rasti nën hetime.

Prishtinë 01/02-12.2020-22:30-05:00. Ankuesi mashkull kosovar ka raportuar se person-a të panjohur me forcë kanë depërtuar në brendinë e shtëpisë së tij dhe nga aty kanë vjedhur dy armë të gjata, kalibri 12 mm, një llap top HP, një portofol me dokumente dhe një shumë e parave. Rasti është duke u hetuar.

Prishtinë 02-12.2020-18:00. Viktima femër kosovare ka raportuar se dy persona të panjohur ia kishin grabitë çantën e krahut në të cilën kishte para, dy kartela të bankës dhe letërnjoftimin. Të dyshuarit pas grabitjes ishin larguar nga ai lokacion. Në vendin e ngjarjes kanë dalë njësitë relevante policore dhe janë duke e hetuar rastin.

Fsh. Krajë, Prizren 02.12.2020-19:00. Viktima mashkull kosovar ka raportuar se persona të panjohur kishin depërtuar në shtëpinë e tij ku kishin vjedhë stoli ari të ndryshme dhe para të gatshme. Në vendin e ngjarjes kanë dalë njësitë policore dhe janë duke e hetuar rastin.


Rugovë 02.12.2020-13:25. Ankuesi mashkull kosovar ka raportuar se person-a të panjohur me forcë kanë depërtuar në brendinë e vilës së tij dhe nga aty kanë arritur të vjedhin : një pistoletë për të cilën kishte leje , një DVR kamera, një TV dhe një makinë rrobalarëse. Rasti vazhdon të hetohet.

Rahovec 02.12.2020-01:47. Ankuesi mashkull kosovar ka raportua se dy persona të panjohur kanë depërtuar me forcë në brendinë marketit dhe nga aty kanë arritur që të vjedhin kasafortën në të cilën ka pasur para. Rasti është duke u hetuar.

Rr. Luja Braja, Mitrovicë 02.12.2020-17:00. Viktima mashkull kosovar, ka raportuar se person-a të panjohur duke dëmtuar tri dyer kanë depërtuar në brendinë e shtëpisë së tij dhe nga aty kanë vjedhur një mjetë pune makinë elektrike për thyerjen e betonit. Rasti vazhdon të hetohet.


Rr. Fitorja, Podujevë 02.12.2020-19:45. Ankuesi mashkull kosovar ka raportuar se person-a të panjohur me forcë kanë depërtuar në brendinë e shtëpisë tij dhe nga aty kanë vjedhur një makinë elektrike – mjet pune dhe dy pasaporta. Rasti është duke u hetuar.

I MË SHUME NGA KRONIKË E ZEZË




Arrestohet i dyshuari në Prizren për dy raste të tentim vrasjes

Postuar 15:38 / 03.12.2020




Vidhen dy automjete në Tetovë

Postuar 13:29 / 03.12.2020




Digjet një kamionetë në autostradën “Ibrahim Rugova”

Postuar 13:14 / 03.12.2020




Vjedhje në një institucion financiar në Lipjan, arrestohet një person

Postuar 12:46 / 03.12.2020




Aksident në Viti, një person i vdekur dhe tre të lënduar

Postuar 12:40 / 03.12.2020




Ushtroi dhunë psikologjike ndaj bashkëshortes, një muaj paraburgim

Postuar 11:16 / 03.12.2020




Dënohen me mbi 9 vjet burgim e 11 mijë euro gjobë tre hakerë

Postuar 11:03 / 03.12.2020




Burri ushtron dhunë psikike ndaj gruas, ajo dërgohet në strehimore

Postuar 10:02 / 03.12.2020




Policia gjen municion në një kanal të ujit në Pejë

Postuar 09:56 / 03.12.2020




Vjedhje në Rugovë të Pejës

Postuar 09:54 / 03.12.2020




Një burrë gjendet i vdekur në një vilë në Gjakovë

Postuar 09:45 / 03.12.2020




Jetesë me personin nën moshën 16 vjeç, policia interviston dy persona

Postuar 09:43 / 03.12.2020




Garaqanicë, kanoset përmes telefonit me vrasje me familje, shkak një borxhi

Postuar 09:35 / 03.12.2020




Rrehen mes vete pastaj sulmojnë edhe policinë, arrestohen dy persona

Postuar 09:34 / 03.12.2020



Podujevë: I hyjnë në shtëpi e ja vjedhin makinën elektrike e dy pasaporta

Postuar 09:33 / 03.12.2020



Hajnat ia marrin çantën nga krahu një femre në Prishtinë

Postuar 09:30 / 03.12.2020